



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

SPECIFIKIME TEKNIKE

ARTIKUJT

KËPUCË TAKTIKE, ME QAFË, VERORE, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

KËPUCË TAKTIKE, ME QAFË, DIMËRORE PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

KËPUCË TAKTIKE, VERORE, PËR STRUKTURAT E VEÇANTA

KËPUCË TAKTIKE, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT ME SHËRBIM NË PLAZHE

KËPUCË DIMËRORE PËR FEMRA DHE MESHKUJ PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

KËPUCË VERORE, PËR MESHKUJ PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

KËPUCË VERORE, PËR FEMRA PËR PUNONJËSET E POLICISË SË SHTETIT

KËPUCË CEREMONIALE, PËR MESHKUJ PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

KËPUCË CEREMONIALE PËR FEMRA PËR PUNONJËSET E POLICISË SË SHTETIT

Specifikimet Teknike të artikujve të mësipërm janë hartuar në përputhje me VKM-në Nr.287 dt.10.05.2019. dhe VKM Nr. 399 dt 01.06.2016. Këto Specifikime Teknike parashtrojnë në mënyrë të detajuar kërkesat themelore teknike të domosdoshme për ndërtimin e prototipit dhe prodhimin e artikullit.

Specifikimet Teknike përcaktojnë gjithashtu edhe kërkesat teknike të aksesorëve që duhet të shoqërojnë artikullin.

Prodhuesit janë të detyruar që t'i zbatojnë të gjitha specifikimet teknike të këtij dokumenti.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Këpucë taktike me qafë, verore për punonjësit e Policisë së Shtetit.

1. MATERIALET

Këpuca duhet të plotësojë kërkesat e specifikuara dhe të markohen me standardin ndërkombëtar për veshjet profesionale EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347-2012 O3 HRO HI CI WR FO SRC ose ekuivalentet.

a. Materialet dhe aksesorët që nevojiten për prodhimin e artikullit.

Materialet*				
Lëkura	Lloji	Lëkurë viçi ose ekuivalente me faqe natyrale		
	Ngjyra	e zezë		
	Trashësia	± 2.0 mm		
	Përshkueshmëria e avullit të ujit	≥ 5.0 mg/cm ² h		
	Regjia	kromike	kromi VI ≤ 3.0mg/kg	
	Rezistenca në grisje	≥ 150 N		
	Rezistenca në përkulje	në të thatë	asnjë dëmtim pas ≥ 80 000 përkuljesh	
		në të njomë	asnjë dëmtim pas ≥20 000 përkuljesh	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	në dritë	4-5 (shkalla blu)		
	në djersë, në fërkim në të njomë dhe të thatë	4-5 (shkalla gri)		
Tekstil teknik	Ngjyra	e zezë		
	Përbërja	mikrofibrë, poliestër, najlon ose kombinim i fibrave të mësipërme.		
	Përshkueshmëria e avullit të ujit	≥ 12.0 mg/cm ² /h		
	Rezistenca në grisje	≥ 60 N		
	Qëndrueshmëria në fërkim në të thatë	≥ 50000 cikle		
	Depërtueshmëria e ujit	Penetrimi	≥ 60 minuti	
		Thithja	≤ 30 % pas 60 minutash	
		Transmetimi	≤ 0.20 g/h	
	Qëndrueshmëria e ngjyrës	në dritë	4-5 (shkalla blu)	
		në djersë, në fërkim në të njomë dhe të thatë	4-5 (shkalla gri)	
Sholla e jashtme	Sholla duhet prej poliuretani ose gome ose poliuretan termoplastik ose ekuivalent dhe duhet të ketë veti antistatike, kundër rrëshqitjes, kundër vajrave dhe duhet të jetë rezistente ndaj hidrokarbureve. (HI HRO WR FO SRC)			
	Ngjyra	e zezë		
	Sipërfaqja	gomë traktori		
	Masa vëllimore	1,12 ± 0,05 gr/cm ³		
	Rezistenca në tërheqje	150 ± 5 kg/cm ³		
	Zgjatja	> 500 %		
	Përthithja e energjisë në thembër	≥ 30 J		
	Fortësia	Shore A	66 ± 5	
	Rezistenca	elektrike	100 MΩ < R ≤ 500 MΩ	
		në këputje	≥ 10,0 kN/m	
		ndaj kontaktit me nxehtësinë	pa dëmtime në T=300°C për 60 sekonda	
		ndaj abrasionit	≤ 150 mm ³	

		ndaj hidrokarbureve	≤ 5,0 %
		ndaj përkuljes së vazhdueshme pas zhytjes	≤ 12%
Sholla e ndërmjetme	E butë, me veti antistatike dhe me veti të lartë të amortizimit të energjisë veçanërisht në zonën e thembrës.		
	Përbërja	Poliuretan ose ekuivalent	
Sholla e brendshme e lëvizshme	Sholla duhet të ketë formë anatomike prej tekstili të pa thurur, të mbuluar nga sipër me tekstil me fibra argjendi.		
	Sholla duhet të ketë aftësi të lartë ajërosëse, me veti antibakteriale dhe antistatike, që mund të lahet në 30°C dhe që thahet shpejt.		
	Trashësia	3-4 mm	
Astar prej tekstili me tre shtresa me membranë PTFE, për pjesën e brendshme të këpucës.	Ngjyra	gri ose e zezë	
	Përbërja	Poliamid ose ekuivalent	
		PTFE	
	Përshkueshmëria e ujit		≥ 1000 mbar, 1 min
	Përshkueshmëria e avullit të ujit		≥ 4.5 mg/cm²h
Astar prej tekstili, që mbulon sfungjerin në pjesën e sipërme të qafës dhe gjuhëzës.	Ngjyra	gri ose e zezë	
	Lloji	rrjetë	
	Përbërja	mikrofibër, poliestër ose najlon	
Material i butë sfungjer për amortizim të brendshëm, mes astarit dhe veshje së jashtme tek qafa, shputa dhe gjuha e këpucës.		aftësia ajërosëse	e lartë
Karton i presuar ose ekuivalent për tabanin.		Trashësia	≥ 2.0 mm
Pllakë përforcuese (kamareta) metalike prej çeliku ose poliuretan termoplastik.			
Insert jo metalik me veti anti çpim me vlerë më të lartë se 0.			
Rezinë termoplastike për kupën e majës dhe të thembrës.			
Aksesorë*			
Zinxhir për mbylljen anësore i papërshkueshëm nga uji.		Dhëmbëzat prej filamenti.	100 % poliacetat
Pllaka gome për mbrojtjen e kaviljeve			
Lidhësa rezistente prej poliamidi ose poliestre methurje gërshet (që nuk shthuren) dhe me ekstremitete plastike.			
Shirit për termosaldimin e qepjeve të astarit.			
Syza metalike ose ganxha (ose kombinim i të dyjave) për lidhësat.			7 çifte
Fill qepës	Ngjyra	E zezë	
	Përberja	100% poliamid ose 100% poliestër	
	Për sovajkën	40/3 Tex	
	Për gjilpërën	30/3 Tex	
	Rezistenca ndaj tërheqjes	≥ 25N	
*Të gjitha materialet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.			
* Të gjitha karakteristikat e tjera fiziko – mekanike dhe kimike që nuk janë përmendur në këtë dokument duhet të jenë ekuivalente ose më të mira se ato të përcaktuara në Standardin EN ISO 20347- 2012 ose ekuivalent.			
O3 - me thembër të mbuluar, me veti antistatike, me veti absorbuese të energjisë tek zona e thembrës, rrezistente ndaj shpimeve dhe rezistencë ndaj përshkueshmërisë dhe thithjes së ujit.			
HRO- rezistenca e shollës ndaj kontaktit në të nxehtë			
HI- izolim nga nxehtësia			
CI- izolim nga i ftohti			
WR- rezistenca ndaj ujit			
FO- rezistenca e shollës ndaj hidrokarbureve			
SRC- rezistenca e shollës ndaj rrëshqitjes			

b. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit të mësipërm duhet të respektojë kërkesat cilësore të mëposhtme:

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e lëkurëve, në të cilat janë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- Prerja nga ana e mishit, por që nuk kalojnë 1/4 e trashësisë
- Gërvishtje mbi faqe
- Dëmtime nga kalbja
- Plasje të faqes nga barazimi
- Gjurmë damarësh
- Ngjyrim jo i njëlojtë
- Njolla yndyre, kromi ose ekstrakti
- Vongoreca e plagë të shëruara.
- Pjesë të dobëta
- Vija majmërie ose rrudha të shtrira në trup e qafë
- Thellime nga rafja
- Valëzime dhe gropëzime
- Pika vrma që bëhen gjatë pickimeve të insekteve kur kafsha është e gjallë.
- Rrudha nga palosjet në kavaletë, që në cilësinë e parë nuk lejohen
- Shkallëzime nga barazimi dhe hollimet nga sharrimi, që nuk lejohen në cilësinë e parë.
- Oksidime
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike

c. Do të lejohen jo më shumë se 3 nga difektet e përcaktuara më poshtë tek tabani i këpucës.

Lloji i defektit	Masa e lejuar
Rrjedhje të shkaktuara nga procesi i vullkanizimit	Trashësi deri 0,5 mm por të jetë rafsh me faqen anësore
Diferenca në trashësi	Lejohet 0,5 mm ±
Vende të pambushura gjatë presimit, Gropa, sipërfaqe jo e lëmuar	gröpa dhe vende të pambushura mirë në të dy faqet, < se 1/4 e trashësisë. Nuk lejohet mosmbushje në filetën anësore që prish konturet.
Gunga të ndryshme	< se 1/3 e trashësisë
Lulëzimi i squfurit në sipërfaqe	Nuk lejohet.

d. Do të lejohen jo më shumë se 3 nga difektet e përcaktuara më poshtë tek sholla e jashtme këpucës.

Lloji i defektit	Masa e lejuar
Filluska	Ana e brendshme
	Sasia deri në 4
	Diametri < 4 mm
	Thellësia deri në 1/6 e trashësisë së shollës
	Distanca > 10 mm nga perimetri i shollës
Gunga	Ana e brendshme

	Lartësia	< 1 mm
	Ana e jashtme dhe anësore	
	Sasia	deri në 3
	Lartësia	< 1 mm
	Diametri	< 1.5 mm
Papastërti të presuara	Ana e brendshme	
	Madhësia	< 4 mm
	Distanca	> 10 mm nga perimetri i shollës
Sipërfaqe jo e lëmuar	Ana e brendshme	ashpërsi e lehtë
	Ana e jashtme dhe anësore	sipërfaqe pa luster
Gropa si rezultat i presimit jo të mirë, rrjedhja jo e mire e materialit, etj.	Ana e brendshme	
	Thellësia	< 0,5 mm
	Sipërfaqja	< 40 mm ²
	Ana e jashtme dhe anësore	
	Thellësia	1/6 e trashësisë së shollës
	Sipërfaqja	20 mm ²
Diseno e spostuar	Lejohet një spostim deri 0,5 mm.	
Prishje e dizenjës anësore	Ana e brendshme e këmbës	< 1 cm në gjatësi të përgjithshme
Ndryshim lartësie, dizenjoje	Lejohet ± 0,5 mm.	
Vende të papresuara	Ana e brendshme	
	Thellësia	< 1 mm
	Sipërfaqja	< 40 mm ²
	Ana e jashtme dhe anësore	nuk lejoen.
Çarje të shollës	Në nëntakë	
	Lejohen çarje në thellësi	sa gjysma e trashësisë < 15 mm nga ana.
	Në pjesët e tjera	nuk lejoen.
Ndryshim përmasash	Kundrejt përmasave të përcaktuara lejoen një ndryshim	
	në gjatësi	- 2 mm
	në gjerësi	+ 2 mm.
Ndryshim mase	Një diferencë prej ± 10% kundrejt masës bazë.	
Ndarje në shtresa e gomës së takës	Nuk Lejohet.	
Poroziteti	Nuk lejoen	
Vrima	Nuk lejoen	
Lulëzimi i sqfurit	Nuk lejoen	

e. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit.

Letër e hollë për mbështjelljen e këpucëve
Forma prej letre për majën dhe ose qafën e këpucës
1 qese silikon ose ekuivalent për një palë këpucë
1 kuti kartoni për një palë këpucë
1 kuti kartoni për paketimin e 10 palë këpucëve


Të gjitha mjetet dhe aksesoret mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli këpucë taktike, verore, me qafë për meshkuj dhe femra do të porositet dhe do të prodhohet në sasi të përkatëse në 10 numra për meshkuj (38-39-40-41-42-43-44-45-46-47) dhe 8 numra për femra (35-36-37-38-39-40-41-42) të cilat subjekti prodhues është i detyruar t'i respektojë saktësisht.

Numrat e këpucëve duhet të respektojnë kërkesat e specifikuara në ISO 9407:2000 ose ekuivalent. Marrja e masave të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



1	Gjatësia e shputës	cm
2	Perimetri i shputës i matur në pjesën më të gjerë të tabanit	cm
3	Perimetri i kurrizit të shputës i matur në pikën më të harkuar	cm
4	Perimetri i shputës në kontrapjetë (kalimi) (i matur transversal nga thembra deri në pikën më të lartë të kurrizit)	cm
5	Perimetri i kyçit të këmbës	cm
6	Perimetri i qafës së këmbës	cm

3. NGJYRA REFERENCË

Ngjyra e zezë është për të gjitha pjesët përbërëse të këpucës.

***Kujdes!** Ngjyrat e paraqitura në këtë specifikim teknik janë ngjyra që prodhuesi duhet t'i ketë si referencë. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.*



4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme, zinxhir për prodhimin me cilësi të artikullit.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve për këpucë. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të përputhen në mënyrë të saktë dhe në to duhet të jenë shënuar shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën.

Prerja

Prerja e lëndëve të para dhe ndihmëse ka të bëjë me prerjen me tranxhë sipas formave të përgatitura të materialeve që nevojiten për ndërtimin e këpucës. Procesi i prerjes duhet të bëhet me shumë kujdes për një shfrytëzim sa më optimal të materialit që pritët. Buzët e detajeve të prera duhet të jenë të pastra sidomos në pjesët e harkuara.

Prerjes me tranxhë sipas formave iu nënshtrohet lëkura, astari, bombës dhe fortit termoplastik dhe kartonit. Sholla nuk duhet të kenë rrjedhje nga procesi i vullkanizimit, diferencë në trashësi, gropa, gunga, sipërfaqe jo të lëmuar dhe lulëzim të sqfurit.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e këpucës të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Proçesi i prodhimit

Proçesi i prodhimit të këpucës ka të bëjë me qepjen dhe montimin e pjesëve përbërëse të këpucës sipas një procesi linear të përcaktuar. Ky proces ndahet në dy faza kryesore.

Faza e parë është përgatitja e pjesës së sipërme të këpucës gjatë të cilës realizohet bashkimi dhe qepja e pjesëve përbërëse prej lëkure së bashku me astarin, fiksimi i bombës dhe fortit termoplastik si dhe fiksimi i kamaretës së celikut tek tabani.

Faza e dytë realizon dhënien e formës së pjesës së sipërme të këpucës me anë të presimit në kallëp, fiksimin e tabanit si dhe montimin e shollës. Punimet përfundimtare dhe lyerja me bojë janë fazat e fundit. Midis proceseve të ndërmjetme të kësaj faze për një përpunim sa më të mirë në përputhje me kërkesat teknologjike, gjysëmprodukti kalon dhe i nënshtrohet proceseve termike në furrën e ngrohjes.

5. NDËRTIMI I KËPUCËS

Skema udhëzuese e ndërtimit dhe prodhimit të prototipit të këpucës për meshkuj dhe femra.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Këto ndryshime ose përmirësime duhet të reflektohen tek udhëzimet dhe specifikimet teknike të prodhimit, të cilat mund t'i bashkangjiten këtij dokumenti zyrtar vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.

Të gjitha fotografitë dhe ilustrimet në këtë dokument shërbejnë vetëm për referencë.



Këpuca taktike verore duhet të jetë e modelit O3, me faqe të kombinuara prej tekstili dhe lëkure, me qafë të gjatë, për përdorim të zgjatur në terren gjatë sezonit të verës.

Pjesët përbërëse të këpucës janë:

- Pjesa e sipërme (tekstil dhe lëkurë)
 - Gjuha
 - Kupa e gishtave
 - Kupa e thembrës
 - Astari
 - Sholla e brendshme e lëvizshme
 - Tabani
 - Sholla e ndërmjetme
 - Sholla e jashtme (goma)
 - Lidhëset
 - Syzat dhe ganxhat
-
- Faqet e këpucës dhe gjuha duhet të jenë prej tekstili teknik, me rezistencë të lartë ndaj gërvishtjeve dhe dëmtimeve.
 - Kupat e gishtave dhe të thembrës duhet të jenë të përforcuara edhe me lëkurë.
 - Bordurat ku do të montohen syzat metalike të lidhëseve dhe bordura e qafës duhet gjithashtu të jenë të përforcuara, me lëkurë dhe në brendësi të këpucës.
 - Lëkura e bordurës së qafës duhet të ketë vrima për ajrosjen e këpucës.
 - Lartësia e qafës së këpucës duhet të jetë 20 - 20.5 cm. Bordura e qafës duhet të jetë e mbushur me sfungjer.
 - Gjuha duhet të jetë e mbyllur me faqen ballore, që të mos lejojë depërtimin e ujit në këpucë.
 - Ngushtimi dhe lirimi i këpucës duhet të bëhet me anë të sistemit të lidhëseve. Syzat e lidhëseve duhet të jenë metalike, të tipit çengel i hapur ose i mbyllur ose kombinim i të dyjave.
 - Përveç sistemit të lidhëseve, këpuca duhet të jetë gjithashtu e pajisur me zinxhir anësor të pozicionuar tek qafa, në anën e brendshme të këmbës, për hapjen dhe mbylljen e këpucës. Zinxhiri duhet të jetë i papërshkueshëm nga uji.
 - Në të dyja anët e qafës së këpucës, tek faqja e jashtme, në nivelin e kavigjës, duhet të montohen dy pllaka gome për mbrojtjen nga goditjet e forta.
 - Në pjesën e pasme, këpuca duhet të jetë e pajisur me ylyk për tërheqjen e këpucës me gisht, gjatë veshjes.
 - Këpuca duhet të jetë e veshur nga brenda me astar me qepje të termosaldura. Astari duhet të ketë aftësi të mira ajërosëse dhe rezistencë ndaj ujit. Mes astarit dhe faqes së jashtme duhet të qepet një shtresë e hollë materiali të butë sfungjer për amortizimin e brendshëm. Sfungjeri duhet të ketë veti të lartë ajërosëse. Qepjet e astarit me tabanin duhet të jenë të termosaldura. Qepjet e astarit dhe bashkimet e tij me pjesët e tjera të këpucës duhet të realizohen në mënyrë të tillë që të mos shkaktojnë fërkime me këmbën gjatë përdorimit.
 - Këpuca duhet të jetë e pajisur me kupa tek gishtat dhe tek thembra. Kupat duhet të jenë prej materiali të fortë termoplastik dhe rezistent ndaj goditjeve.



- Sholla e lëvizshme e këpucës duhet të ketë formë anatomike, duhet të jetë e mbuluar me tekstil në sipërfaqen e sipërme, duhet të ketë veti antistatike, antibakteriale, duhet të ketë veti të lartë ajërosëse, të lahet në 30°C dhe që thahet shpejt.
- Tabani i këpucës duhet të jetë prej materiali cilësor me veti elastike dhe rezistencë të lartë ndaj përthyerjeve të shpeshta në terreneve të vështira.
- Këpuca duhet të pajiset me një shtresë mes tabanit dhe shollës së jashtme për mbrojtjen e këmbës nga çpimi prej materialeve të mprehta.
- Sholla e ndërmjetme duhet të jetë e injektuar në brendësi të shollës së jashtme. Ajo duhet të jetë prej poliuretani ose prej materiali tjetër ekuivalent. Ajo duhet të jetë e butë dhe me veti antistatike. Ajo duhet të ketë veti të lartë të amortizimit të energjisë veçanërisht në zonën e thembrës.
- Sholla e jashtme e këpucës duhet të jetë e tipit traktor, prej gome, me rezistencë të lartë ndaj gërvishjeve, rrëshqitjes, vajrave dhe hidrokarbureve. Ngjitja e shollës me faqet e këpucës duhet të mos lejojë depërtimin e ujit në brendësi të këpucës. Lulet e shollës duhet të kenë mjaftueshëm hapësira që të mos mbledhin guriçka të vogla ose baltë gjatë përdorimit në terren të vështirë.
- Këpuca duhet të pajiset tek zona e thembrës me pllakë përforcuese (kamareta) metalike ose poliuretan termoplastik të vendosur mes tabanit dhe shollës së jashtme.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Këpuca duhet të markohet, në pjesën e gjuhëzës me këtë informacion:
EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347- 2012 O3 HRO HI CI WR FO SRC
- Afati i dorëzimit në magazinë nga data e prodhimit të këpucës nuk duhet të jetë më i lartë se 12 muaj.
- Këpucët duhet të jenë të qepura mirë, të jenë të buta, të lehta, të jenë të rehatshme në përdorim dhe të duken të rregullta kur të vishen nga punonjësit e *Policisë së Shtetit*.
- Këpucët duhet të jenë të lehta për tu mirëmbajtur.
- Tek lëkura defektet lejohen deri në 4% të sipërfaqes, nga të cilat jo më shumë se 2% në kurriz (krupon).
- Lëkura për faqe këpucësh duhet të jetë:
 - e butë dhe e vajosur mirë
 - e ngjeshur dhe kompakte
 - e pastruar nga ana e mishit
 - e mbushur dhe e regjur shumë mirë
 - e shtrirë mirë në të gjithë sipërfaqen,
 - e barazuar dhe të zmeriluara
- Lëkura për faqe këpucësh duhet të ketë:
 - rezistencë maksimale ndaj njollave, ujit dhe nxehtësisë,
 - ngjyrosje uniforme dhe të qëndrueshme në të gjithë sipërfaqen,
 - formë të rregullt.
 - Lëkura nuk duhet të egërsohet mbas lagës dhe montimit.
- Lëkura duhet t'i rezistojë tërheqjes dhe të mos çahet gjatë qepjes.
- Këpuca duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Këpuca duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përshkueshmërisë së ujit dhe të sigurojë ajërim të mirë të këmbës.
- Këpuca duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj vajrave, agjentëve kimikë si dhe të ketë aftësi reflektive të rrezeve të diellit.
- Membrana prej Polytetrafluoroethylene (PTFE) duhet të jetë e puthitur mirë me astarin. Në sipërfaqen e saj nuk duhet të ketë flluska me diametër $\geq 4\text{mm}$.
- Sholla prej gome duhet të presohet me kujdes që të mos krijohen vende të pambushura ose të çara.
- Sholla prej gome nuk duhet të ketë rrjedhje nga procesi i vullkanizimit, diferencë në trashësi, gropa, gunga, sipërfaqe jo të lëmuar dhe lulëzim të squfurit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së këpucëve duhet të jenë me hap 3 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniforme, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe qëndrueshmëria duhet të jetë mbi 9kg.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
 - Tegelat qepës duhet të jenë me termosaldim.
 - Nuk lejohet çarje nga gjilpëra dhe prishje e tegelit.
- Të gjithë elementët e këpucës duhet të jenë simetrikë.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e këpucëve është $\pm 2\%$.
- Lëkura, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyres.
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Secila palë e këpucëve duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa.

Etiketa duhet të qepet në astarin e brendshëm të gjuhës së këpucës. Në sipërfaqen e jashtme të gjuhës së këpucës duhet të markohen simbolet sipas çertifikimit të këpucës.

Masa e këpucëve, duhet të vendoset poshtë shojeve të gomës në mënyrë të dukshme.

Në momentin e dorëzimit këpucët duhet të jenë të lyera me bojë, të pastra dhe të rregullta.

Paketimi i këpucës duhet të bëhet në kuti të vogla kartoni me kapak sipas masës dhe gjinisë. Në secilën kuti do të futen një palë këpucë dhe një qesë e vogël me silikon.

Të gjitha kutitë e vogla të të njëjtës masë dhe gjini do të vendosen në kuti kartoni të mëdha.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar modeli i këpucës, masa, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKSI - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Këpuca	
Këpucët duhet të jenë konform standardit ISO 20344: 2011	
Këpucët duhet të jenë konform standardit ISO 20347: 2012 O3 HRO HI CI WR FO SRC	
Lëkura	
Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja	ISO 17131:2012 Lëkurë - Identifikimi i lëkurës me mikroskop.
Trashësia	ISO 2589:2016 Lëkurë - Testet fizike dhe mekanike - Përcaktimi i trashësisë.
Përshkueshmëria e avullit të ujit	ISO 14268-2012 Lëkurë - Testet fizike dhe mekanike- Përshkueshmëria e avullit të ujit.
Regjia	ISO 17075-2017 Lëkurë - Përcaktimet kimike të përmbajtjes së kromit (VI) në lëkurë.
Rezistenca në grisje	ISO 3377: 2016 Lëkurë - Provat fizike dhe mekanike - Përcaktimi i ngarkesës në grisje.
Rezistenca në përkulje	ISO 5402-1:2017 Lëkurë - Përcaktimi i rezistencës të përkuljes - Pjesa 1: Metoda me fleksometër
Qëndrueshmëria e ngjyrës së lëkurës	ISO 105 B02: 2014 Testet e qëndrueshmërisë së ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në dritë.
	ISO 11641: 2012 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në dërsitje.
	ISO 11640: 2013 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës -Qëndrueshmëria e ngjyrës në ciklet e fërkimit para-mbrapa.
Tekstili teknik	
Përbërja %	ISO 1833: 2010 Tekstile - Analizat kimike sasiore.
Përshkueshmëria e avullit të ujit	ISO 11092: 2014 Tekstile - Efektet fiziologjike - Matja e qëndrueshmërisë termike nën ndikimin e avujve të ujit në kushte të qëndrueshme (prova e pjatës së nxehtë të mbrojtur nga dërsitja)

Rezistenca në grisje	ISO 20344: 2011 Pjesa - Përcaktimi i ngarkesës në grisje.
Qëndrueshmëria në fërkim në të thatë	ISO 12947-2: 2016 Tekstilet: Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Depërtueshmëria e ujit	EN 20811:1992, ISO 811:1981 Tekstilet- Përcaktimi i rezistencës ndaj depërtimit të ujit
Qëndrueshmëria e ngjyrës së tekstilit	ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
	ISO 105-E04 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të njomë.
Sholla	
Masa vëllimore	ISO 2781:2018 Goma, e vullkanizuar ose me termoplastifikim- Përcaktimi i densitetit.
Rezistenca në tërheqje dhe zgjatja	EN ISO 12803:2000 Këpucë - Metodën e provës që zbatohen për shojet e jashtme të këpucëve - Forca në tërheqje dhe zgjatja
Përthithja e energjisë në thembër	ISO 20347:2012 - 6.2.4 Pajisje mbrojtëse personale - Këpucët profesionale - Përthithja e energjisë në thembër
Fortësia	ISO 48-4:2018 Goma, e vullkanizuar ose me termoplastifikim - Përcaktimi i densitetit - Përcaktimi i fortësisë - Pjesa 4: Identifikimi i fortësisë me metodën me durometër (fortësia në shore)
Rezistenca	ISO 20344:2011 Pajisje mbrojtëse personale - Metodën e provës për këpucët ISO 20347:2012 Pajisje mbrojtëse personale - Këpucët profesionale

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Këpuçë taktike me qafë, dimërore, për punonjësit e Policisë së Shtetit.

1. MATERIALET

Këpuca duhet të plotësojë kërkesat e specifikuara dhe të markohen me standardin ndërkombëtar për veshjet profesionale EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347-2012 O3 HRO HI CI WR FO SRC ose ekuivalentet.

a. Materialet dhe aksesorët që nevojiten për prodhimin e artikullit.

Materialet*				
Lëkura	Lloji	Lëkurë viçi ose ekuivalente me faqe natyrale		
	Ngjyra	e zezë		
	Trashësia	± 2.0 mm		
	Përshkueshmëria e avullit të ujit	≥ 5.0 mg/cm²h		
	Regjia	kromike	kromi VI ≤ 3.0mg/kg	
	Rezistenca në grisje	≥ 150 N		
	Rezistenca në përkulje	në të thatë	asnjë dëmtim pas ≥80 000 përkuljesh	
		në të njomë	asnjë dëmtim pas ≥20 000 përkuljesh	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	në dritë	4-5 (shkalla blu)		
	në djersë, në fërkim në të njomë dhe të thatë	4-5 (shkalla gri)		
Shollë e jashtme	Sholla duhet prej poliuretani ose gome ose poliuretan termoplastik ose ekuivalent , kundër rrëshqitjes, kundër vajrave dhe duhet të jetë rezistente ndaj hidrokarbureve. (HI HRO WR FO SRC)			
	Ngjyra	e zezë		
	Sipërfaqja	gomë traktori		
	Masa vëllimore	1,12 ± 0,05 gr/cm³		
	Rezistenca në tërheqje	150 ± 5 kg/cm³		
	Zgjatja	> 500 %		
	Përthithja e energjisë në thembër	≥ 30 J		
	Fortësia	Shore A	66 ± 5	
	Rezistenca	elektrike	100 MΩ < R ≤ 500 MΩ	
		në këputje	≥ 10,0 kN/ m	
		ndaj kontaktit me nxehtësinë	pa dëmtime në T=300°C për 60 sekonda	
		ndaj abrasionit	≤ 150 mm³	
		ndaj hidrokarbureve	≤ 5,0 %	
	Rezistenca	ndaj përkuljes së vazhdueshme pas zhytjes	≤ 12%	
Sholla e ndërmjetme	E butë, me veti antistatike dhe me veti të lartë të amortizimit të energjisë veçanërisht në zonën e thembrës.			
	Përbërja	Poliuretan ose ekuivalent		
Sholla e brendshme e lëvizshme.	Sholla duhet të ketë formë anatomike dhe e mbuluar nga sipër me tekstil me veti antibakteriale.			
	Ajo mund të përbëhet prej sfungjeri të hollë (memory foam) ose prej EVA (etinel vinil acetat) ose prej poliuretani ose kombinim i materialeve të sipërpërmendura.			
	Sholla duhet të ketë aftësi të lartë ajërosëse, me veti antibakteriale dhe antistatike, që mund të lahet në 30°C dhe që thahet shpejt.			
	Trashësia	5 - 10 mm		

Astar prej tekstili me tre shtresa me membranë PTFE, për pjesën e brendshme të këpucës.	Ngjyra	gri ose e zezë		
	Përbërja	Poliamid ose ekuivalent		
		PTFE		
	Përshkueshmëria e ujit		≥ 1000 mbar, 1 min	
Përshkueshmëria e avullit të ujit		≥ 4.5 mg/cm²h		
Astar prej tekstili, që mbulon sfungjerin në pjesën e sipërme të qafës dhe gjuhëzës.	Ngjyra	gri ose e zezë		
	Lloji	rrjetë		
	Përbërja	mikrofibër, poliestër ose najlon		
Material i butë sfungjer për amortizim të brendshëm, mes astarit dhe veshje së jashtme tek qafa, shputa dhe gjuha e këpucës.		aftësia ajërosëse	e lartë	
Karton i presuar ose ekuivalent për tabanin.		Trashësia	jo më pak se 2.0 mm	
Pllakë përforcuese (kamareta) metalike prej çeliku ose poliuretan termoplastik.				
Insert jo metalik me veti anti çpim me vlerë më të lartë se 0.				
Rezinë termoplastike për kupën e majës dhe të thembrës.				
Aksesorë*				
Zinxhir për mbylljen anësore i papërshkueshëm nga uji.		Dhëmbëzat prej filamenti.	100 % poliacetat	
Pllaka gome për mbrojtjen e kaviljeve				
Lidhësa rezistente prej poliamidi ose poliestre methurje gërshtet (që nuk shthuren) dhe me ekstremitete plastike.				
Shirit për termosaldimin e qepjeve të astarit.				
Syza metalike ose ganxha (ose kombinim i të dyjave) për lidhësat.			7 çifte	
Fill qepës	Ngjyra	E zezë		
	Përberja	100% poliamid ose 100% poliester		
	Për sovajkën	40/3 Tex		
	Për gjilpërën	30/3 Tex		
	Rezistenca ndaj tërheqjes	≥ 25N		
*Të gjitha materialet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.				
* Të gjitha karakteristikat e tjera fiziko – mekanike dhe kimike që nuk janë përmendur në këtë dokument duhet të jenë ekuivalente ose më të mira se ato të përcaktuara në Standardin EN ISO 20347- 2012 ose ekuivalent.				
O3 - me thembër të mbuluar, me veti antistatike, me veti absorbuese të energjisë tek zona e thembrës, rrezistente ndaj shpimeve dhe rezistencë ndaj përshkueshmërisë dhe thithjes së ujit.				
HRO- rezistenca e shollës ndaj kontaktit në të nxehtë				
HI- izolim nga nxehtësia				
CI- izolim nga i ftohti				
WR- rezistenca ndaj ujit				
FO- rezistenca e shollës ndaj hidrokarbureve				
SRC- rezistenca e shollës ndaj rrëshqitjes				

b. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit të mësipërm duhet të respektojë kërkesat cilësore të mëposhtme:

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e lëkurëve, në të cilat janë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- Prerja nga ana e mishit, por që nuk kalojnë 1/4 e trashësisë
- Gërvishje mbi faqe
- Dëmtime nga kalbja
- Plasje të faqes nga barazimi
- Gjurmë damarësh
- Ngjyrim jo i njëlojtë

- Njolla yndyre, kromi ose ekstrakti
- Vongoreca e plagë të shëruara.
- Pjesë të dobëta
- Vija majmërie ose rrudha të shtrira në trup e qafë
- Thellime nga rafja
- Valëzime dhe gropëzime
- Pika vrime që bëhen gjatë pickimeve të insekteve kur kafsha është e gjallë.
- Rrudha nga palosjet në kavaletë, që në cilësinë e parë nuk lejohen
- Shkallëzime nga barazimi dhe hollimet nga sharrimi, që nuk lejohen në cilësinë e parë.
- Oksidime
- dhe çdo parregullsi tjetër që cënon anën funksionale dhe estetike

c. Do të lejohen jo më shumë se 3 nga difektet e përcaktuara më poshtë tek tabani i këpucës.

Lloji i defektit	Masa e lejuar	
Rrjedhje të shkaktuara nga procesi i vullkanizimit	Trashësi	deri 0,5 mm por të jetë rafsh me faqen anësore
Diferenca në trashësi	Lejohet 0,5 mm ±	
Vende të pambushura gjatë presimit, Gropa, sipërfaqe jo e lëmuar	gropa dhe vende të pambushura mirë në të dy faqet, < se ¼ e trashësisë.	
	Nuk lejohet mosmbushje në filetën anësore që prish konturet.	
Gunga të ndryshme	< se 1/3 e trashësisë	
Lulëzimi i sqfurit në sipërfaqe	Nuk lejohet.	

d. Do të lejohen jo më shumë se 3 nga difektet e përcaktuara më poshtë tek sholla e jashtme këpucës.

Lloji i defektit	Masa e lejuar	
Flluska	Ana e brendshme	
	Sasia	deri në 4
	Diametri	< 4 mm
	Thellësia	deri në 1/6 e trashësisë së shollës
	Distanca	> 10 mm nga perimetri i shollës
Gunga	Ana e brendshme	
	Lartësia	< 1 mm
	Ana e jashtme dhe anësore	
	Sasia	deri në 3
	Lartësia	< 1 mm
	Diametri	< 1.5 mm
Papastërti të presuara	Ana e brendshme	
	Madhësia	< 4 mm
	Distanca	> 10 mm nga perimetri i shollës

Sipërfaqe jo e lëmuar	Ana e brendshme	ashpërsi e lehtë
	Ana e jashtme dhe anësore	sipërfaqe pa lustër
Gropa si rezultat i presimit jo të mirë, rrjedhja jo e mirë e materialit, etj.	Ana e brendshme	
	Thellësia	< 0,5 mm
	Sipërfaqja	< 40 mm ²
	Ana e jashtme dhe anësore	
	Thellësia	1/6 e trashësisë së shollës
	Sipërfaqja	20 mm ²
Disenjo e spostuar	Lejohet një spostim deri 0,5 mm.	
Prishje e dizenjës anësore	Ana e brendshme e këmbës	< 1 cm në gjatësi të përgjithshme
Ndryshim lartësie, dizenjoje	Lejohet ± 0,5 mm.	
Vende të papresuara	Ana e brendshme	
	Thellësia	< 1 mm
	Sipërfaqja	< 40 mm ²
	Ana e jashtme dhe anësore	nuk lejohen.
Çarje të shollës	Në nëntakë	
	Lejohen çarje në thellësi	sa gjysma e trashësisë < 15 mm nga ana.
	Në pjesët e tjera	nuk lejohen.
Ndryshim përmasash	Kundrejt përmasave të përcaktuara lejohen një ndryshim	
	në gjatësi	- 2 mm
	në gjerësi	+ 2 mm.
Ndryshim mase	Një diferencë prej ± 10% kundrejt masës bazë.	
Ndarje në shtresa e gomës së takës	Nuk Lejohet.	
Poroziteti	Nuk lejohet	
Vrima	Nuk lejohen	
Lulëzimi i sqfurit	Nuk lejohet	

e. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit.

Letër e hollë për mbështjelljen e këpucëve
Forma prej letre për majën dhe ose qafën e këpucës
1 qese silikon ose ekuivalent për një palë këpucë
1 kuti kartoni për një palë këpucë
1 kuti kartoni për paketimin e 10 palë këpucëve


Të gjitha mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli këpucë taktike, dimërore, me qafë për meshkuj dhe femra do të porositet dhe do të prodhohet në sasi të përkatëse në 10 numra për meshkuj (38-39-40-41-42-43-44-45-46-47) dhe 8 numra për femra (35-36-37-38-39-40-41-42) të cilat subjekti prodhues është i detyruar t'i respektojë saktësisht.

Numrat e këpucëve duhet të respektojnë kërkesat e specifikuara në ISO 9407:2000 ose ekuivalent. Marrja e masave të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



1	Gjatësia e shputës	cm
2	Perimetri i shputës i matur në pjesën më të gjerë të tabanit	cm
3	Perimetri i kurrizit të shputës i matur në pikën më të harkuar	cm
4	Perimetri i shputës në kontrapjetë (kalim) (i matur transversal nga thembra deri në pikën më të lartë të kurrizit)	cm
5	Perimetri i kyçit të këmbës	cm
6	Perimetri i qafës së këmbës	cm

3. NGJYRA REFERENCË

Ngjyra e zezë është për të gjitha pjesët përbërëse të këpucës.

Kujdes! Ngjyrat e paraqitura në këtë specifikim teknik janë ngjyra që prodhuesi duhet t'i ketë si referencë. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.



4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme, zinxhir për prodhimin me cilësi të artikullit.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve për këpucë. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të përputhen në mënyrë të saktë dhe në to duhet të jenë shënuar shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën.

Prerja

Prerja e lëndëve të para dhe ndihmëse ka të bëjë me prerjen me tranxhë sipas formave të përgatitura të materialeve që nevojiten për ndërtimin e këpucës. Procesi i prerjes duhet të bëhet me shumë kujdes për një shfrytëzim sa më optimal të materialit që pritet. Buzët e detajeve të prera duhet të jenë të pastra sidomos në pjesët e harkuara.

Prerjes me tranxhë sipas formave iu nënshtrohet lëkura, astari, bombës dhe fortit termoplastik dhe kartonit. Sholla nuk duhet të kenë rrjedhje nga procesi i vullkanizimit, diferencë në trashësi, gropa, gunga, sipërfaqe jo të lëmuar dhe lulëzim të sqfurit.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e këpucës të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Procesi i prodhimit

Procesi i prodhimit të këpucës ka të bëjë me qepjen dhe montimin e pjesëve përbërëse të këpucës sipas një procesi linear të përcaktuar. Ky proces ndahet në dy faza kryesore.

Faza e parë është përgatitja e pjesës së sipërme të këpucës gjatë të cilës realizohet bashkimi dhe qepja e pjesëve përbërëse prej lëkure së bashku me astarin, fiksimi i bombës dhe fortit termoplastik si dhe fiksimi i kamaretës së çelikut tek tabani.


Faza e dytë realizon dhënien e formës së pjesës së sipërme të këpucës me anë të presimit në kallëp, fiksimin e tabanit si dhe montimin e shollës. Punimet përfundimtare dhe lyerja me bojë janë fazat e fundit. Midis proceseve të ndërmjetme të kësaj faze për një përpunim sa më të mirë në përputhje me kërkesat teknologjike, gjysmë-produkti kalon dhe i nënshtrohet proceseve termike në furrën e ngrohjes.

5. NDËRTIMI I KËPUCËS

Skema udhëzuese e ndërtimit dhe prodhimit të prototipit të këpucës për meshkuj dhe femra.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Këto ndryshime ose përmirësime duhet të reflektohen tek udhëzimet dhe specifikimet teknike të prodhimit, të cilat mund t'i bashkangjiten këtij dokumenti zyrtar vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.

Të gjitha fotografitë dhe ilustrimet në këtë dokument shërbejnë vetëm për referencë



Këpuca taktike dimërore duhet të jetë e modelit O3 e ndërtuar tërësisht me lëkurë, me qafë të gjatë, për përdorim të zgjatur në terren gjatë sezonit të dimrit.

Pjesët përbërëse të këpucës janë:

- Pjesa e sipërme (lëkurë)
 - Gjuha
 - Kupa e gishtave
 - Kupa e thembrës
 - Astar
 - Sholla e brendshme e lëvizshme
 - Tabani
 - Sholla e ndërmjetme
 - Sholla e jashtme (goma)
 - Lidhëset
 - Syzat dhe ganxhat
-
- Pjesa e sipërme e këpucës duhet të jetë prej lëkure.
 - Lartësia e qafës së këpucës duhet të jetë 20 - 20.5 cm
 - Gjuha duhet të jetë e mbyllur me faqen ballore, që të mos lejojë depërtimin e ujit në këpucë.
 - Ngushtimi dhe lirimi i këpucës duhet të bëhet me anë të sistemit të lidhëseve. Syzat e lidhëseve duhet të jenë metalike të tipit çengel i hapur ose i mbyllur ose kombinim i të dyjave.
 - Bordurat ku do të montohen syzat metalike të lidhëseve duhet të jenë të përforcuara në brendësi të këpucës.
 - Përveç sistemit të lidhëseve, këpuca duhet të jetë gjithashtu e pajisur me zinxhir anësor të pozicionuar tek qafa, në anën e brendshme të këmbës, për hapjen dhe mbylljen e këpucës. Zinxhiri duhet të jetë i papërshkueshëm nga uji.
 - Në të dyja anët e qafës së këpucës, tek faqja e jashtme, në nivelin e kaviljes, duhet të montohen dy pllaka gome për mbrojtjen nga goditjet e forta.
 - Pjesët e bordurës së qafës dhe gjuhës duhet të kenë vrima për ajrosjen e këpucës.
 - Në pjesën e pasme, këpuca duhet të jetë e pajisur me ylyk për tërheqjen e këpucës me gisht, gjatë veshjes.
 - Këpuca duhet të jetë e veshur nga brenda me astar me qepje, të termosaldura. Astar duhet të ketë aftësi të mira ajërosëse dhe rezistencë ndaj ujit. Mes astarit dhe faqes së jashtme duhet të qepet një shtresë e hollë materiali të butë sfungjer për amortizimin e brendshëm. Sfungjeri duhet të ketë veti të lartë ajërosëse. Qepja e astarit me tabanin duhet të jenë të termosaldura për ti bërë këpucët e papërshkueshme nga uji. Qepjet e astarit dhe bashkimet e tij me pjesët e tjera të këpucës duhet të realizohen në mënyrë të tillë që të mos shkaktojnë fërkime me këmbën gjatë përdorimit.
 - Këpuca duhet të jetë e pajisur me kupa tek gishtat dhe tek thembra. Kupa duhet të jenë prej materiali të fortë termoplastik dhe rezistent ndaj goditjeve.
 - Sholla e lëvizshme e këpucës duhet të ketë formë anatomike, me veti antistatike, antibakteriale, duhet të ketë veti të lartë ajërosëse, të lahet në 30°C dhe që thahet shpejt.



- Tabani i këpucës duhet të jetë prej materiali cilësor me veti elastike dhe rezistencë të lartë ndaj përthyerjeve të shpeshta në terrene të vështira.
- Këpuca duhet të pajiset me një shtresë mes tabanit dhe shollës së jashtme për mbrojtjen e këmbës nga çpimi prej materialeve të mprehta.
- Sholla e ndërmjetme duhet të jetë e injektuar në brendësi të shollës së jashtme këpucës. Ajo duhet të jetë prej poliuretani ose prej materiali tjetër ekuivalent. Ajo duhet të jetë e butë dhe me veti antistatike. Ajo duhet të ketë veti të lartë të amortizimit të energjisë veçanërisht në zonën e thembrës.
- Sholla e jashtme e këpucës duhet të jetë e tipit traktor, prej gome, me rezistencë të lartë ndaj gërvishtjeve, rrëshqitjes, vajrave dhe hidrokarbureve. Ngjitja e shollës me faqet e këpucës duhet të mos lejojë depërtimin e ujit në brendësi të këpucës. Lulet e shollës duhet të kanë mjaftueshëm hapësira që të mos mbledhin guriçka të vogla ose baltë gjatë përdorimit në terren të vështirë.
- Këpuca duhet të pajiset tek zona e thembrës me pllakë përforcuese (kamareta) metalike os poliuretan termoplastik të vendosur mes tabanit dhe shollës së jashtme.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Këpuca duhet të markohet, në pjesën e gjuhëzës me këtë informacion:
ISO 20347-2012 O3 HRO HI CI WR FO SRC
- Afati i dorëzimit në magazinë nga data e prodhimit të këpucës nuk duhet të jetë më i lartë se 12 muaj.
- Këpucët duhet të jenë të qepura mirë, të jenë të buta, të lehta, të jenë të rehatshme në përdorim dhe të duken të rregullta kur të vishen nga punonjësit e *Policisë së Shtetit*.
- Këpucët duhet të jenë të lehta për tu mirëmbajtur.
- Tek lëkura defektet lejohen deri në 4% të sipërfaqes, nga të cilat jo më shumë se 2% në kurriz (krupon).
- Lëkura për faqe këpucësh duhet të jetë:
 - e butë dhe e vajosur mirë
 - e ngjeshur dhe kompakte

- e pastruar nga ana e mishit
- e mbushur dhe e rregjur shumë mirë
- e shtrirë mirë në të gjithë sipërfaqen,
- e barazuar dhe të zmeriluara
- Lëkura për faqe këpucësh duhet të ketë:
 - rezistencë maksimale ndaj njollave, ujit dhe nxehtësisë,
 - ngjyrosje uniforme dhe të qëndrueshme në të gjithë sipërfaqen,
 - formë të rregullt.
 - Lëkura nuk duhet të egërsohet mbas lagjes dhe montimit.
- Lëkura duhet t'i rezistojë tërheqjes dhe të mos çahet gjatë qepjes.
- Këpuca duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Këpuca duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përshkueshmërisë së ujit dhe të sigurojë ajërim të mirë të këmbës.
- Këpuca duhet të ketë rezistentë maksimale ndaj vajrave, agjentëve kimikë si dhe të ketë aftësi reflektive të rrezeve të diellit.
- Membrana prej Polytetrafluoroethylene (PTFE) duhet të jetë e puthitur mirë me astarin. Në sipërfaqen e saj nuk duhet të ketë fluska me diametër $\geq 4\text{mm}$.
- Sholla prej gome duhet të presohet me kujdes që të mos krijohen vende të pambushura ose të çara.
- Sholla prej gome nuk duhet të ketë rrjedhje nga procesi i vullkanizimit, diferencë në trashësi, gropa, gunga, sipërfaqe jo të lëmuar dhe lulëzim të sqfurit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së këpucëve duhet të jenë me hap 3 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniforme, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe qëndrueshmëria duhet të jetë mbi 9kg.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
 - Tegelat qepës duhet të jenë me termosaldim.
 - Nuk lejohet çarje nga gjilpëra dhe prishje e tegelit.
- Të gjithë elementët e këpucës duhet të jenë simetrikë.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e këpucëve është $\pm 2\%$.
- Lëkura, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës.
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Secila palë e këpucëve duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa.

Etiketa duhet të qepet në astarin e brendshëm të gjuhës së këpucës. Në sipërfaqen e jashtme të gjuhës së këpucës duhet të markohen simbolet sipas çertifikimit të këpucës.

Masa e këpucëve, duhet të vendoset poshtë shojeve të gomës në mënyrë të dukshme.

Në momentin e dorëzimit, këpucët duhet të jenë të lyera me bojë, të pastra dhe të rregullta.

Paketimi i këpucës duhet të bëhet në kuti të vogla kartoni me kapak sipas masës dhe gjinisë. Në secilën kuti do të futen një palë këpucë dhe një qesë e vogël me silikon.

Të gjitha kutitë e vogla të të njëjtës masë dhe gjini do të vendosen në kuti kartoni të mëdha.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m^2) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar modeli i këpucës, masa, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjites (natriban).

ANEKSI - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Këpuca	
Këpucët duhet të jenë konform standardit ISO 20344: 2011	
Këpucët duhet të jenë konform standardit ISO 20347: 2012 O3 HRO HI CI WR FO SRC	
Lëkura	
Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve ISO*
Përbërja	ISO 17131:2012 Lëkurë - Identifikimi i lëkurës me mikroskop.
Trashësia	ISO 2589:2016 Lëkurë - Testet fizike dhe mekanike - Përcaktimi i trashësisë.
Përshkueshmëria e avullit të ujit	ISO 14268:2012 Lëkurë - Testet fizike dhe mekanike- Përshkueshmëria e avullit të ujit.
Regjia	ISO 17075-2017 Lëkurë - Përcaktimet kimike të përmbajtjes së kromit (VI) në lëkurë.
Rezistenca në grisje	ISO 3377: 2016 Lëkurë - Provat fizike dhe mekanike - Përcaktimi i ngarkesës në grisje.
Rezistenca në përkulje	ISO 5402-1:2017 Lëkurë - Përcaktimi i rezistencës të përkuljes - Pjesa 1: Metoda me fleksometër
Qëndrueshmëria e ngjyrës së lëkurës	ISO 105 B02: 2014 Testet e qëndrueshmërisë së ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në dritë.
	ISO 11641: 2012 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në djersitje.
	ISO 11640: 2013 Lëkurë - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës -Qëndrueshmëria e ngjyrës në ciklet e fërkimit para-mbrapa.
Sholla	
Masa vëllimore	ISO 2781:2018 Goma, e vullkanizuar ose me termoplastifikim- Përcaktimi i densitetit.
Rezistenca në tërheqje dhe zgjatja	EN ISO 12803:2000 Këpucë - Metodat e provës që zbatohen për shojet e jashtme të këpucëve - Forca në tërheqje dhe zgjatja
Përthithja e energjisë në thembër	ISO 20347:2012 - 6.2.4 Pajisje mbrojtëse personale - Këpucët profesionale - Përthithja e energjisë në thembër
Fortësia	ISO 48-4:2018 Goma, e vullkanizuar ose me termoplastifikim - Përcaktimi i densitetit - Përcaktimi i fortësisë - Pjesa 4: Identifikimi i fortësisë me metodën me durometër (fortësia në shore)
Rezistenca	ISO 20344:2011 Pajisje mbrojtëse personale - Metodat e provës për këpucët ISO 20347:2012 Pajisje mbrojtëse personale - Këpucët profesionale

* Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Këpuçë taktike me qafë të shkurtër, verore, për strukturat e veçanta.

1. MATERIALET

Këpuca duhet të plotësojë kërkesat e specifikuara dhe të markohen me standardin ndërkombëtar për veshjet profesionale EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347-2012 O3 HRO HI CI WR FO SRC ose ekuivalentet.

a. Materialet dhe aksesorët që nevojiten për prodhimin e artikullit.

Materialet*				
Lëkura	Lloji	Lëkurë viçi ose ekuivalente me faqe natyrale		
	Ngjyra	e zezë		
	Trashësia	± 2.0 mm		
	Përshkueshmëria e avullit të ujit	≥ 5.0 mg/cm ² h		
	Regjia	kromike	kromi VI ≤ 3.0mg/kg	
	Rezistenca në grisje	≥ 150 N		
	Rezistenca në përkulje	në të thatë	asnjë dëmtim pas ≥80 000 përkuljesh	
		në të njomë	asnjë dëmtim pas ≥20 000 përkuljesh	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	në dritë	4-5 (shkalla blu)		
	në djersë, në fërkim në të njomë dhe të thatë	4-5 (shkalla gri)		
Tekstil teknik	Ngjyra	e zezë		
	Përbërja	mikrofibrë, poliestër, najlon ose kombinim i fibrave të mësipërme.		
	Përshkueshmëria e avullit të ujit	≥ 12.0 mg/cm ² /h		
	Rezistenca në grisje	≥ 60 N		
	Qëndrueshmëria në fërkim në të thatë	≥ 50000 cikle		
	Depërtueshmëria e ujit	Penetrimi	≥ 60 minuti	
		Thithja	≤ 30 % pas 60 minutash	
		Transmetimi	≤ 0.20 g/h	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	në dritë	4-5 (shkalla blu)		
	në djersë, në fërkim në të njomë dhe të thatë	4-5 (shkalla gri)		
Sholla e jashtme	Sholla duhet prej poliuretani ose gome ose poliuretan termoplastik ose ekuivalent dhe duhet të ketë veti antistatike, kundër rrëshqitjes, kundër vajrave dhe duhet të jetë rezistente ndaj hidrokarbureve. (HI HRO WR FO SRC)			
	Ngjyra	E zezë		
	Sipërfaqja	gomë traktori		
	Masa vëllimore	1,12 ± 0,05 gr/cm ³		
	Rezistenca në tërheqje	150 ± 5 kg/cm ³		
	Zgjatja	> 500 %		
	Përthithja e energjisë në thembër	≥ 30 J		
	Fortësia	Shore A	66 ± 5	
	Rezistenca	Elektrike	100 MΩ < R ≤ 500 MΩ	
		në këputje	≥ 10,0 kN/m	
		ndaj kontaktit me nxehtësinë	pa dëmtime në T=300°C për 60 sekonda	

		ndaj abrasionit	≤ 150 mm ³
		ndaj hidrokarbureve	≤ 5,0 %
		ndaj përkuljes së vazhdueshme pas zhytjes	≤ 12%
Sholla e ndërmjetme	E butë, me veti antistatike dhe me veti të lartë të amortizimit të energjisë veçanërisht në zonën e thembrës.		
	Përbërja	Poliuretan ose ekuivalent	
Sholla e brendshme e lëvizshme	Sholla duhet të ketë formë anatomike prej tekstili të pa thurur, të mbuluar nga sipër me tekstil me fibra argjendi.		
	Sholla duhet të ketë aftësi të lartë ajërosëse, me veti antibakteriale dhe antistatike, që mund të lahet në 30°C dhe që thahet shpejt.		
	Trashësia	3-4 mm	
Astar prej tekstili me tre shtresa me membranë PTFE, për pjesën e brendshme të këpucës.	Ngjyra	gri ose e zezë	
	Përbërja	Poliamid ose ekuivalent	
		PTFE	
			shtrese tekstili me aftësi të lartë të thithjes së lagështirës
	Përshkueshmëria e ujit		≥ 1000 mbar, 1 min
	Përshkueshmëria e avullit të ujit		≥ 4.5 mg/cm ² h
Astar prej tekstili, që mbulon sfungjerin në pjesën e sipërme të qafës dhe gjuhëzës.	Ngjyra	gri ose e zezë	
	Lloji	Rrjetë	
	Përbërja	mikrofibrë, poliestër ose najlon	
Material i butë sfungjer për amortizim të brendshëm, mes astarit dhe veshje së jashtme tek qafa, shputa dhe gjuha e këpucës.		aftësia ajërosëse	e lartë
Karton i presuar ose ekuivalent për tabanin.		Trashësia	≥ 2.0 mm
Pllakë përforcuese (kamareta) metalike prej çeliku ose poliuretan termoplastik.			
Insert jo metalik me veti anti çpim me vlerë më të lartë se 0.			
Rezinë termoplastike për kupën e majës dhe të thembrës.			
Aksesorë*			
